



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:246244

Datë: 19.04.2023

Numri i dokumentit: 04202355

C.nr.3874/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Rezarta Sylejmani Voca, në çështjen juridike kontestimore të paditësit G.. B.. nga P.., me adresë në rr. M.. K.. nr.1.., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. Xh.. K.. nga P.., kundër të paditurës K.. Gj.. i K.. me seli në P.., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.. M.., jurist, me objekt të kontestit kompensim i dëmit material dhe jo material si pasojë e privimit të lirisë, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit kryesor publik në prani të përfaqësuesit të paditësit më datë 06.04.2023, me datë 14.04.2023 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET PJESËRISHT kërkesëpadia e paditësit G.. B.. nga P.., dhe **DETYROHET** e paditura K.. Gj.. i K.. me seli në P.., që paditësit në emër të dëmit material dhe jo material, për privim të pa arsyeshëm nga liria për shkak të paraburgimit prej datës 15.07.2018 e deri me datë 02.08.2018, gjithsej 19 ditë, t'ia paguaj shumat e specifikuar si në vijim:

i. Në emër të dëmit jo material:

a. Në emër të dhimbjeve shpirtërore për shkak të cenimit të autoritetit, nderit, dinjitetit personal, shumën prej.....
950.00 €.

ii. Në emër të dëmit material:

b. Në emër të shpenzimeve të krijuara në procedurë penale në emër të mbrojtjes nga avokati, shumën prej.....
.....800.00 €.

- II. DETYROHET** e paditura K.. Gj.. i K., që paditësit për pjesën e aprovuar të padisë t'ia paguaj kamatën si për mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar, për dëmin jomaterial kamata do të rrjedh nga data e marrjes së aktgjykimit 14.04.2023, kurse për dëmin material nga dita e paraqitjes së padisë më datën 27.12.2018, e deri në pagesën e tërësishme si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në lartësi prej 279 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh nga pranimi i aktgjykimit.
- III. REFUZOHET E PABAZUAR** pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit G.. B.. nga P.. mbi shumat e aprovuara, dhe atë: në emër të vuajtjeve shpirtërore për cenim të autoritetit, nderit dhe dinjitetit personal shumë prej 2,550.00 € si dhe refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit për kompensimin e dëmin material-fitimit të humbur për veturën e mbajtur në parkingun privat, në formën e fitimit të humbur në shumë prej 300€.

A r s y e t i m

I. Kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësi G.. B.. nga P., përmes përfaqësuesit të tij ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë më datën 27.12.2018, kundër të paditurit K.. Gj.. i K., me objekt të kontestit kompensim i dëmit për shkak të privimit të kundërligjshëm të lirisë. Ka theksuar se me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prizren, PPR.nr.49/18 të datës 16.07.2018 i është caktuar masa e paraburgimit në kohëzgjatje prej 19 ditësh, në cilësi të akuzuarit, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale blerja, posedimi, shpërndarja ose shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge. Tutje sipas padisë ka theksuar se me aktvendimin e datës 01.08.2018 janë pushuar hetimet ndaj tij kurse sipas aktvendimit të datës 02.08.2018 i është ndërprerë paraburgimi. Si rezultat i procedurës penale, ka theksuar se padrejtësisht ka qëndruar në paraburgim nga data 15.07.2018 e deri më datën 02.08.2018, për 19 ditë, andaj ka kërkuar kompensimin e dëmit jo material dhe atë për një natë qëndrimi në burg shumë prej 20 euro, për shpenzimet e mbrojtjes në procedurën gjyqësore shumë prej 800 euro, si dhe shpenzimet në emër të fitimit të humbur për shkak të qëndrimit të veturës së tij të markës T.. me targa të regjistrimit 01-.. K.. në parkingun privat V.. në P., shumë prej 300 euro.

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij e ka bërë precizimin e padisë, ashtu që ka kërkuar nga e paditura në emër të dëmit jo material, për vuajtjet e përjetuara për 19 ditët gjatë qëndrimit në paraburgim, t'ia kompensoj shumë prej 3,500.00 euro; në emër të dëmit material- fitimit të

humbur për shkak të qëndrimit të veturës së tij në parkingun privat gjatë kohës sa ka qenë në paraburgim, shumën prej 300.00 euro; në emër të shpenzimeve të krijuara për mbrojtjen në procedurën gjyqësore shumën prej 800.00 euro, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive. Me propozim që padia dhe kërkesëpadia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Në përgjigjen në padi, në seancat e mbajtura, përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës nuk e ka kontestuar bazën juridike të kërkesëpadisë por e ka kundërshtuar lartësinë e kompensimit. Ka theksuar se e paditura përmes Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2015 për zbatimin e procedurës së kompensimit të dëmit për personat e dënuar ose të arrestuar pa arsye, ka paraparë lartësinë 9 euro në ditë për dëmin material dhe 6 euro në ditë për dëmin jo material. Ka theksuar se konform kriterëve të parapara sipas këtij Udhëzimi është e gatshme t'ia kompensoj në emër të dëmit material shumën prej 171.00 euro dhe në emër të dëmit jo material shumën prej 114.00 euro, në emër të shpenzimeve të përfaqësimit nga ana e avokatit shumën prej 120 euro, në emër të shpenzimeve të vizitave familjare dhe pakove shumën prej 25.00 euro, krejt këto në shumën e përgjithshme prej 430.00 euro. Pjesën tjetër të kërkesëpadisë e kundërshton në tërësi si të pabazuar duke shtuar se paditësi me asnjë provë nuk e ka dëshmuar se makina e shitur pas sekuestrimit ka qenë e dëmtuar ose ka pasur korezion siç është pretenduar. Me propozim për gjykatën që pjesën tjetër të kërkesëpadisë përtej shumave të gjykuara ta refuzoj si të pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

II. Provat e administruara lidhur me vërtetimin e gjendjes faktike

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat: Lexohen provat materiale: Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren PP.nr.49/18 i datës 16.07.2018, Aktvendimi për pushimin e hetimeve nga PTH në Prizren PP/I.nr.81/2018 i datës 01.10.2018, Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda PP.nr.49/18 i datës 02.08.2018, Raporti i lëshuar nga NTSH “V..” në P.. i datës 15.07.2018”, Fatura e datës 02.11.2018 e lëshuar nga Av. H.. S.. nga P.., Fatura e datës 08.11.2018 e lëshuar nga Av. H.. S.. nga P.., Fatura e datës 21.11.2018 e lëshuar nga Av. H.. S.. nga P..

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Nga provat shkresore të administruara, por edhe nga pohimet e palëve ndërgjyqëse, para gjykatës rezultoi të jetë fakt i pa kontestuar se paditësi ka qenë i privuar nga liria, sipas aktvendimeve të Gjykatës Themelore në Prizren e më pas i liruar nga përgjegjësia penale.

Çështje kryesore kontestuese mes palëve ndërgjyqëse ishte nëse paditësi ka të drejtë në lartësinë e shumave të kërkuara të kompensimit ku sipas të paditurës kompensimet e kërkuara nga paditësi duhet të bëhen sipas Vendimit të K.. Gj.. mbi Kriteret e Përgjithshme për Kompensimin e dëmit të Personave të Dënuar ose të Arrestuar pa Arsye, kurse për këtë në thelb palët kishin pikëpamje diametralisht të kundërta.

Me leximin e Aktvendimit të Gjykatës Themelore Prizren Ppr.nr.49/18 të datës 16.07.2018, Gjykata gjeti se paditësit për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale blerja posedimi shpërndarja ose shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga nenin 273 par.2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së , i është caktuar paraburgimi në kohëzgjatje prej një muaj, konkretisht nga data 15.07.2018 deri më 14.08.2018.

Me leximin e Aktvendimit PP./I.nr.81/2018 të datës 01.10.2018, gjykata vërtetoi se Prokuroria Themelore në Prizren – Departamenti për Krime të Rënda, ka marrë Aktvendim për pushimin e Hetimeve ndaj të pandehurit- në këtë rast paditësit, me efekt nga data 01.10.2018. Kurse sipas Aktvendimit të datës 02.08.2018, të Gjykatës Themelore në Prizren Ppr.nr/49/18, paditësit i ndërpritet masa e paraburgimit dhe i njëjti lëshohet në liri me datën 02.08.2018. Sipas këtij aktvendimi masa e paraburgimit i zëvendësohet me masën e paraqitjes në stacioni policor, në kohëzgjatje deri më datë 14.08.2018.

Me leximin e Raportit të lëshuar nga Ndërmarrja Raportuese Shërbyese V.. në P., e datës 15.07.2018, gjykata ka vërtetuar se ky dokument përmban vetëm shënimin mbi shumën e paguar ën shumën prej 300 euro e cila i është kompensuar kësaj Ndërmarrje, ndërsa nuk përmban shënime të dhëna tjera konkrete.

Me leximin e faturës të datës 02.11.2018, të lëshuar nga avokati H. S. nga P. , gjykata ka vërtetuar se avokati H. S. ka lëshuar faturën me përshkrimin për: G. B., ku vlera e shërbimeve të ofruara është shënuar në shumën prej 500.00 euro. **Përmes faturës së datës 08.11.2018**, gjykata ka vërtetuar se avokati H. S. nga P. në emër të shërbimeve të kryera ka lëshuar faturën me përshkrimin : për G. B., ku vlera e shërbimeve të ofruara është shënuar në shumën prej 100.00 euro. Kurse **Përmes faturës së datës 21.11.2018**, gjykata ka vërtetuar se avokati H. S. nga P. në emër të shërbimeve të kryera ka lëshuar faturën me përshkrimin: për G. B., ku vlera e shërbimeve të ofruara është shënuar në shumën prej 200.00 euro. Faturat e lartcekura janë të nënshkruara dhe të vulosura me vulë të avokatit në fjalë.

III. Ligji i zbatueshëm

Të drejtën e kompensimit të personave të mbajtur, arrestuar dhe paraburgosur pa arsye e parasheh edhe Konventa Evropiane për të Drejtat, e cila ka aplikim direkt në Kosovë, duke u integruar përmes nenit 22 par. 7 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Sipas nenit 5 par. 5 të kësaj Konvente “Çdo person që arrestohet ose burgoset në kundërshtim me dispozitat e këtij neni ka të drejtën për të kërkuar dëmshpërblim”.

Kurse sipas neni 185 paragrafi 1i të njëjti ligj përcakton:” *Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e ekzistuar para se të shkaktohej dëmi. Lidhur me paragrafin 3:”Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundshme apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që ta bëjë këtë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t’ia paguajë dëmtuesit shumën përkatëse në të holla për efekt të kompensimit të dëmit. Kurse sipas neni 189, i dëmtuari ka të drejtë si për kompensimin e dëmit të thjeshtë ashtu edhe për kompensimin e fitimit të munguar.*

E drejta e kompensimit të personave të paraburgosur pa të drejtë, rregullohet sipas Vendimit të K. Gj. mbi Kriteret e Përgjithshme për Kompensimin e dëmit të Personave të Dënuar ose të Arrestuar pa Arsye datë 03.07.2007 (i aplikuar në kohën kur paditësi është privuar nga liria), lidhur me dëmin jo material, neni 5 i këtij vendimi parashikon: *Dëmi jo material/moral në emër të dhimbjeve të përjetuara psikike/shpirtërore, frikës së përjetuar, ndjenjës së turpfit, shuma e përcaktuar e kompensimit është 180€ në muaj për personat e dënuar ose të arrestuar pa arsye/paraburgosur.*

Po ashtu një e drejtë e tillë parashihet edhe me nenin 529 të Kodin të Procedurës Penale të Kosovës, sipas të cilit: *E drejta e kompensimit të dëmit i takon personit i cili është mbajtur në paraburgim e kundër tij nuk është filluar procedurë penale ose procedura është pushuar me aktvendim të formës së prerë ose ai me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza apo akuza është refuzuar.*

Gjithashtu aplikoi dispozitën nga neni 136 par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve Gazeta Zyrtare nr.29/78 (i aplikuar në kohën kur paditësi ishte në kufizim të lirisë, pra në kohën kur ka ndodhur dëmi), sipas se cilës dispozitë “*kush i shkakton dëm tjetrit është i detyruar t’ia kompensoj për deri sa te mos provoj se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij*”, gjykata konsideron se e paditura në rastin konkret duhet ta korrigjoj demin e shkaktuar paditësit me paraburgim të pa drejtë, pasi paditësi me aktgjykim është liruar nga akuza.

Kurse për sa i përket kategorisë së kompensimit të dëmit jo material gjykata ka aplikuar nenin 183 par 1 të LMD, sipas të cilit *Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të jetës të prishjes, të shkeljes së nderit ose të lirisë, të vdekjes së personit të afërm si dhe për frikën gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit për frikën dhe zgjatja e tyre justifikon këtë, do të gjykojë kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi dëmit material dhe nga mungesa e dëmit material. Kurse në paragrafin 2 të këtij neni parashihet *Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit shërben ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos të u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror.**

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

IV. Përkitazi me shumën e gjykuara.

Gjykata vlerëson se tek ky rast përmbushen elementet e lidhjes shkakore që paraqet raportin e ndërsjellët ndërmjet veprimit të dëmshëm dhe dëmit, në të cilin veprimi i dëmshëm paraqitet si shkak, kurse dëmi si pasojë e tij. Pra lidhja kauzale është një ndër kushtet e përgjithshme për lindjen e përgjegjësisë për dëmin e shkaktuar, që ekziston midis veprimit ose mosveprimit të dëmshëm dhe dëmit të shkaktuar. Gjykata arriti në përfundim se privimi i kundërligjshëm i lirisë së paditësit për 19 ditë, ka ndodhur pa fajin e paditësit kurse atij i është shkaktuar dëm, e që në

rastin konkret konsiston në dëmin jo material mbi friken e përjetuar, degradim të personalitetit, dinjitetit, cenim ndaj nderit, të drejtave dhe lirive themelore njerëzore, të cilat kanë ndikuar me pasoja si në jetën, personale, profesionale, miqësore dhe shume relacione tjera njerëzore.

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut në vendimin e dhënë *Vasilevskiy dhe Bogdanov kundër Ruisisë* (2018), lidhur me kompensimin e personave të dënuar pa arsye, ka shprehur qëndrim se detyra e vlerësimit të dëmit që duhet dhënë personit si kompensim është e vështirë, veçanërisht kur kemi të bëjmë me një rast kur janë në shprehje të drejtat personale, si dhe vuajtja, çoftë fizike apo mendore, është objekt i kërkesës për kompensim. Po ashtu në këtë vendim është thënë se nuk ka ndonjë standard me të cilën dhimbjet shpirtërore, shqetësimi psikologjik dhe ankthi mund të maten në një kundërvlerë të saktësisht të matshme të parave. Më tej Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut përmes këtij vendimi ka thënë se vlerësimi nga ana e gjykatave i shumave të matshme të kompensimit, duhet të bëhet duke u bazuar në kritere të qëndrueshme të cilat duhet të marrin parasysh standardin e jetës të vendit. Sido që të jetë, Gjykata Evropiane ka theksuar se nuk mund të lejohet një shumë tejet e ulët e kompensimit, e cila do të ishte aq e ulët saqë do të *minonte* frymën e vërtetë të nenit 5.5 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, ngase do të humbiste thelbin e zbatueshmërisë së këtij neni, i cili garanton të drejtën e kompensimit të personave të dënuar apo paraburgosur pa arsye.

Gjykata gjatë vendosjes lidhur me lartësinë e shpërblimit për dëmin jo material, ka marrë për bazë Udhëzuesin e Gjykatës Supreme të Kosovës , sipas të cilit është përcaktuar që për një ditë heqje lirie, kompensimi të jetë prej 30.00 euro deri në 60.00 euro. Andaj duke marrë parasysh kriteret orientuese të cilat parashihen për përcaktimin e llogaritjeve të kompensimit sipas këtij Udhëzimi, si dhe rrethanat tjera siç janë kohëzgjatja e privimit nga liria, natyra e veprës për të cilën ka qenë i akuzuar paditësi, moshën dhe rrethanat familjare të tij, gjykata ka vendosur si në pikën I (a) të dispozitivit të këtij vendimi.

Gjykata vlerëson se shumata e gjykuara për paditësin paraqesin një satisfaksion moral dhe shpagim real për format e dëmeve të pësuar nga ai gjatë kohës së qëndrimit në paraburgim, dhimbjet shpirtërore dhe frikës së përjetuar të paditësit, e të cilat gjykata i caktoi sipas bindjes së lirë konform dispozitave nga neni 322 dhe 323 të LPK-së si dhe nenit 183 të LMD-së, si dhe duke pasur si orientim kriteret dhe masat e vëna nga praktika gjyqësore lidhur me lartësinë e dëmeve jo materiale, posaçërisht lidhur kompensimet e kësaj natyre.

Andaj, në këtë kuptim, Gjykata duke vepruar konform përcaktimeve të dhëna nga Udhëzuesi i lartcekur, i cili parasheh se nuk ka arsye për nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmia e psikiatrisë pasi vuajtjet janë evidente dhe nuk ka nevojë të provohen me ekspertizë, ka refuzuar propozimin e të autorizuarit të paditësit për nxjerrjen e provës me ekspertizë nga lëmia e psikiatrisë. Përfundimisht sipas këtij udhëzues nxjerrja e kësaj prove parashihet vetëm kur i dëmtuari ka histori të trajtimit mjekësorë të aspektit psikiatrik, siç nuk është në rastin konkret me paditësin, pasi që i njëjti nuk ka ofruar ndonjë provë materiale për gjykatën që dëshmon se ka pranuar shërbime në këtë drejtim.

Gjykata vlerësoj pretendimet e të paditurës në lidhje me atë se gjykata në lidhje me përcaktimin e lartësisë së kompensimit të vendosë sipas Udhëzimit Administrativ 04/2015 të K..-së, por gjykata të njëjtat pretendime nuk i mori për bazë pasi që i njëjti Udhëzim Administrativ në nenin 13.4 parasheh që nëse pala nuk pajtohet me shumën e ofruar nga ana e komisionit, ajo duhet të nënshkruaj këtë mospajtim dhe me këtë fiton të drejtën që në procedurën e rregull gjyqësore, me padi civile të kërkojë kompensimin e dëmit për të cilën pala pretendon se i takon. Në rastin konkret paditësi ka vepruar sipas udhëzimit, por nuk është pajtuar me shumën e ofruara për kompensim nga komisioni dhe kjo vërtetohet nga ofertën e dhënë nga e paditura dhe me paraqitjen e padisë pranë gjykatës.

Me nenin 30 paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës parashihet: *“çdokush që akuzohet për veprë penale, gëzon të drejtat minimale në vijim: të ketë ndihmën e një mbrojtësi që e zgjedh, të komunikoj lirisht me të dhe nëse nuk ka mjete të mjaftueshme, ti sigurohet mbrojtja falas”*.

Me nenin 57 par.1 të KPPRK-së parashihet:” i pandehuri duhet të ketë mbrojtës në këto raste të mbrojtjes së detyruar: nënpar.1.2:”*gjatë seancës për caktimin e paraburgimit dhe gjatë kohës derisa ai gjendet në paraburgim; nënpar.1.3:” nga ngritja e aktakuzës, kur është ngritur argumentimi me prova materiale i seancave të mbajtura.*

Gjykata duke pasur parasysh faktin se vepra penale për të cilën ka qenë i akuzuar ka qenë me dënueshmëri të lartë, dhe për faktin se paditësi gjatë gjithë fazave të procedurës penale ka qëndruar në paraburgim, (deri në kohën e ndërprerjes së masës së paraburgimit dhe zëvendësimit të kësaj mase me masën e paraqitjes në stacionin policor) dhe mbi bazën e këtyre rrethanave mbrojtja ka qenë e detyruar dhe sikur vet paditësi të mos angazhonte mbrojtës me shpenzime të tij, ka qenë

obligim i gjykatës që të caktoj mbrojtës me shpenzime publike në kuptim të nenit 57 paragrafi 2 lidhur me paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.3 të KPPRK-së.

Gjykata vendosi si në dispozitivin e I (një) pika (b) duke aprovuar kërkesëpadinë në emër të shpenzimeve të krijuara në procedurë penale në emër të mbrojtjes nga avokati, si dëm material, shumën prej 800.00 €, ngase nga aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti për Krime të Rënda P.nr.49/18 i datës 16.07.2018, gjykata ka vërtetuar se paditësi është mbrojtur nga avokati H. S. nga P.. Andaj, faturave të administruara në cilësi të provave materiale në këtë procedurë gjyqësore, gjykata ua fali besimin ngase të njëjtat janë lëshuar nga personi i cili e ushtron profesionin e avokatit dhe i cili evidentohet si mbrojtës i paditësit ne procedurën penale, ku pas administrimit të të njëjtave, gjykata ka vërtetuar lartësinë në emër të këtij shpërblimi.

Gjykata gjatë vendosjes pati parasysh pretendimet e të paditurës lidhur me mungesën e transaksioneve bankare nga paditësi në llogarit të avokatit, mirëpo të njëjtat nuk patën ndikim për vendosje ndryshe pasi që tani më praktika gjyqësore njeh shpenzimet e përfaqësimit në procedurat gjyqësore si në çështjet civile ashtu edhe në ato penale edhe në mungesë të faturave, por me vetë faktin e përfaqësimit të palës me avokat në seancë, e cila në këtë rast është provuar nga paditësi për pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë, si dhe është vërtetuar përmes faturave të administruara në këtë procedurë gjyqësore.

V. Lidhur me pjesën refuzuese të kërkesëpadisë

Gjykata vendosi si në dispozitivin e III tretë të këtij aktgjykimi duke e refuzuar kërkesëpadinë përtej shumave të gjykuara, dhe atë për dëmin jo material: në emër të vuajtjeve shpirtërore për shkak të qëndrimit në paraburgim nga data 15.07.2018 deri me 02.08.2018, shumën prej 2,550.00 €, ngase vlerësoi se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me qëllimin e kompensimit dhe në pajtim me praktikën gjyqësore, pavarësisht faktit se kufizimi i lirë përbën cenimin e një të drejte thelbësore dhe vështirë rikuperohet.

Gjykata ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit për kompensimin e dëmit material për shkak të mbajtjes së veturës në parkingun privat, siç pretendon paditësi me padi, pasi që ka vlerësuar se fatura e lëshuar nga Ndërmarrja Transportuese Shërbyese V., nuk përmban të dhëna që vërtetojnë se ka të bëjë me veturën e paditësit apo të dhëna lidhur me pronarin e veturës, po ashtu nuk përmban të dhëna lidhur me arsyen e faturimit dhe lidhur me personin i cili ka paguar dhe

ka pranuar faturë. Andaj bazuar në të lartcekurat, Gjykata nuk ia fali besimin faturës në fjalë, ngase e njëjta nuk vërteton lidhjen kauzale se si pasojë e privimit të kundërligjshëm, paditësi ka pasur dëm material si rezultat i shpenzimeve të krijuara për mbajtjen e veturës në parkingun privat.

Sipas nenit 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), është paraparë se “ palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe te propozojnë prova me të cilat konstatohen fakte të tilla”, andaj për gjatë tërë zhvillimit të procedurës, gjykata është e lidhur vetëm me propozimet dhe provat të cilat i propozojnë palët ndërgjyqëse.

Duke qenë se pas administrimit të provave, gjykata ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë, ka vërtetuar se paditësit i takon edhe kamatëvonesa. Lidhur me kërkesën për kamatën ligjore sa i përket kompensimit të dëmit material dhe jo material është vendosur në kuptim të nenit 382 të LMD-se në lidhje me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020 pika VI, XIV dhe XV dhe XVIII të saj.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452 par 2 të LPK-së, ku me rastin e vendosjes gjykata ka pas parasysh se paditësi pjesërisht ka pas sukses në kontest, bazuar në këtë i ka njohur paditësit shpenzimet e procedurës dhe atë për taksën gjyqësore në padi shumë prej 40 €, për përpilimin e padisë shumë prej 104.00€, përfaqësim për një seancë gjyqësore shumë prej 135€, krejt këto në shumë të përgjithshme prej 279.00€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr.3874/18 datë 14.04.2023

Gjyqtarja

Rezarta Sylejmani Voca

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.